

20191532394

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE

### Neni 1

Në Ligjin për komunikime elektronike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 98/19), në nenin 13 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në rast kur Agjencia i zbaton detyrimet e veta për bartje të të hyrave të realizuara në pajtim me nenin 29-a të këtij ligji."

### Neni 2

Në nenin 29 paragrafi (9) shlyhet.

### Neni 3

Pas nenit 29 shtohet titull i ri dhe nen i ri 29-a, si vijon:

#### "Neni 29-a

#### **Financimi i Agjencisë Operative Teknike**

(1) Agjencia është e obliguar që një pjesë të mjeteve të realizuara nga të hyrat nga kompensimet e përcaktuara në këtë kapitull t'i bartin si mjete të dedikuara për financim të veprimtarisë së Agjencisë Operative Teknike, për shkak të sigurimit të resurseve adekuate financiare, njerëzore dhe teknike me qëllim që Agjencia Operative Teknike të mund t'i zbatojë kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Agjencisë Operative Teknike dhe Ligjin për ndjekje të komunikimeve si vijon:

- 50% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara të cilat Agjencia i ka realizuar për vitin paraprak kalendarik nga të hyrat nga kompensimet vjetore të cilat operatorët i paguajnë për mbikëqyrje të tregut, të përcaktuara në raportin vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak kalendarik, i miratuar nga Komisioni i Agjencisë dhe

- 10% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara të cilat Agjencia i ka realizuar për vitin paraprak kalendarik nga të hyrat nga kompensimet vjetore për shfrytëzimin e radiofrekuencave nga ana e poseduesve të lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave, të përcaktuara në raportin vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak kalendarik, të miratuar nga Komisioni i Agjencisë.

(2) Shumat nga paragrafi (1) të këtij neni Agjencia është e obliguar t'ia paguajë Agjencisë Operative Teknike më së voni deri më 15 prill të vitit rrjedhës."

### Neni 4

Pas nenit 71 shtohen pesë tituj të rinj dhe pesë nene të reja 71-a, 71-b, 71-v, 71-g dhe 71-d, si vijojnë:

#### "Neni 71-a

#### **Zyra Nacionale për Kompetencë Brodbend - ZNKB (Broadband Competence Office)**

(1) Zyra Nacionale për Kompetencë Brodbend ( në tekstin e mëtejme: ZNKB) është trup ekspertësh dhe këshillëdhënës për mbështetje të investimeve në rrjetet brodbend.

(2) ZNKB i ka këto kompetenca:

- merr pjesë në punën e rrjetit të zyrave për kompetencë brodbend në Bashkimin Evropian dhe në rajon,

- jep mendime dhe propozime për arritje të zhvillimit më të shpejtë të komunikimeve elektronike, e posaçërisht të brodbendit në shtet,

- bashkëpunon me organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet dhe entet publike, si dhe personat juridikë me autorizime publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore dhe siguron mbështetje për planet/projektet/studimet zhvillimore të lidhura me rrjete brodband, si dhe mbështetje në zbatimin e tyre,

- jep mendime dhe propozime për shfrytëzimin dhe zhvillimin e nevojshëm të infrastrukturës optike e cila është ndërtuar ose do të ndërtohet me mjete publike,

- merr pjesë gjatë përcaktimit të sferave qëllimore në të cilat do të shfrytëzohet ndihma shtetërore për ndërtim dhe zhvillim të rrjeteve brodbend,

- jep mendime dhe propozime gjatë ndërtimit të rrjeteve brodbend me shfrytëzim të ndihmës shtetërore për: zgjidhje të mundshme teknike, modele investuese dhe të biznesit, kushte për zgjedhje të operatorit, politikë të çmimeve dhe çështje të ndërlidhura;

- merr pjesë, jep mendime dhe propozime gjatë përgatitjes së planeve për promovim të brodbendit në shtet,

- merr pjesë në debate publike dhe konsultime që kanë të bëjnë në ndërtimin e brodbend rrjeteve përmes shfrytëzimit të ndihmës shtetërore,

- merr pjesë gjatë përcaktimit të lokacioneve për sigurimin e qasjes së internetit falas pa tela WIFI në komuna,

- merr pjesë, jep mendime dhe propozime gjatë përgatitjes së dokumenteve dhe planeve të ardhshme nacionale strategjike për zhvillim të cilat kanë lidhshmëri me zhvillimin e brodbendit,

- e ndjek zbatimin e dokumenteve dhe planeve strategjike nacionale të miratuara për zhvillim të brodbendit në shtet, përmbushjen e targeteve nacionale brodband të përcaktuara në të njëjtat dhe jep mendime dhe propozime për revidimin e të njëjtave,

- së paku dy herë në vit përgatit raport për ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për zhvillimin e brodbendit në shtet në lidhje me zhvillimin e tregut brodbend në Bashkimin Evropian, në pajtim me DESI (The Digital Economy and Society Index) dhe raport për zbatimin e dokumenteve dhe planeve strategjike të miratuara për zhvillimin e brodbandit në shtet, përmbushjen e targeteve nacionale brodband të përcaktuara në të njëjtat.

(3) ZNKB për punën e vet përgjigjet para ministrit të Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 71-6

### **Përbërja e ZNKB**

(1) ZNKB përbëhet nga shtatë anëtarë nga të cilët njëri është Kryetarë i ZNKB-së.

(2) Kryetarin e ZNKB-së e emëron ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës nga radhët e të punësuarve në ministri për periudhë prej pesë vitesh.

(3) Gjashtë anëtarë të ZNKB-së janë ekspertë të pavarur, të zgjedhur nëpërmjet konkursit publik, në pajtim me këtë ligj.

(4) ZNKB formohet me aktvendim të miratuar nga ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Neni 71-v

**Konkursi publik për anëtar në ZNKB**

(1) Konkursin publik për zgjedhjen e ekspertëve të pavarur nga neni 71-b paragrafi (2) i këtij ligji e shpall ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(2) Konkursi publik nga paragrafi (1) të këtij neni shpallet në së paku tri gazeta ditore, të cilat shtypen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra nga gazetat që shtypen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(3) Afati për paraqitje të kandidatëve për anëtarë të ZNKB-së në konkursin publik zgjat pesë ditë, duke llogaritur nga dita e fundit e shpalljes së konkursit publik në gazetata ditore.

(4) Me fletëparaqitje në konkursin publik, kandidatët për anëtarë të ZNKB-së janë të detyruar të dorëzojnë edhe:

- dëshmi për shtetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- dëshmi se me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës të lëshuar nga gjykata kompetente,

- certifikatë për së paku 240 kredi të marra sipas SETK ose shkallën VII/1 të përfunduar të arsimit nga sfera e teknologjive informative komunikuese,

- dëshmi për përvojë pune së paku 10 vjet nga sfera e teknologjive informative komunikuese,

- rekomandim për njohje përkatëse të sferës së brodbendit dhe

- deklaratë të vërtetuar në noter se persona të afërt nuk janë të punësuar në operator dhe se nuk kanë lidhur marrëveshje për bashkëpunim me të njëjtin, se nuk janë pronarë të aksioneve ose pjesëmarrjeve, drejtpërdrejt ose tërthorazi në operatorë, dhe se nuk janë anëtarë të organit udhëheqës ose mbikëqyrës ose të ushtrojnë funksion menaxhues në operator.

(5) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës miraton aktvendim për zgjedhjen e ekspertëve të pavarur anëtarë të ZNKB-së më së voni në afat prej dhjetë ditësh, llogaritur nga dita e skadimit të afatit për aplikimin e kandidatëve për anëtarë të ZNKB-së në konkursin publik.

(6) Anëtarët e ZNKB-së zgjidhen për kohëzgjatje prej pesë vitesh, me të drejtë të rizgjedhjes së sërishme.

Neni 71-g

**Kushtet që duhet t'i plotësojnë anëtarët e ZNKB-së**

(1) Anëtarët e ZNKB-së mund të jenë persona me arsim të lartë dhe me së paku 10 vjet përvojë pune në sferën e teknologjive informative komunikuese.

(2) Anëtarët duhet të kenë njohje përkatëse nga sfera e brodbendit, e posaçërisht për:

- Rregullativën vendore dhe Evropiane për komunikime elektronike (posaçërisht për brodbend) dhe për shfrytëzim të ndihmës shtetërore për zhvillim të brodbendit,

- planifikim strategjik, zhvillim dhe punë me rrjete brodbend,

- zgjidhje teknike, modele investuese dhe të biznesit, kushte për zgjedhje të operatorit, politikën e çmimeve,

- shfrytëzimin e aplikacioneve për planifikimin dhe dizajnimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, sistemeve gjeografike të informacionit dhe aplikacioneve tjera që janë të rëndësishme për kompetencat e ZNKB-së.

(3) Kandidatët për anëtarë të ZNKB-së e dëshmojnë plotësimin e kushtit të paragrafit (2) të këtij neni me bashkëngjitjen e rekomandimit për njohje përkatëse të sferës së brodbendit.

(4) Anëtarë i ZNKB-së dhe persona të afërt të tij nuk mund të jenë të punësuar në operator ose të kenë lidhur marrëveshje për bashkëpunim me të njëjtin, të jenë pronarë të aksioneve ose pjesëmarrjeve, drejtpërdrejt ose tërthorazi në operatorë, ose të jenë anëtarë të organit udhëheqës ose mbikëqyrës ose të ushtrojnë funksion menaxhues në operator.

(5) Anëtari i ZNKB-së mund të shkarkohet para skadimit të mandatit nëse:

- parashtron kërkesë për shkarkimin e tij,
- pushon t'i plotësojë kushtet që kanë të bëjnë për anëtarë të ZNKB-së,
- në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme e ushtron funksionin e tij si anëtar i ZNKB-së dhe
- nëse nuk ka mundësi ta realizojë detyrën më shumë se gjashtë muaj në vazhdimësi.

Neni 71-d

### **Mënyra e punës së ZNKB-së**

(1) Kryetari i ZNKB-së e përfaqëson ZNKB-në, i cakton mbledhjet, kryeson me to dhe merr pjesë në punën e rrjetit të ZNKB-së në Bashkimin Evropian dhe në rajon, e në rast të mungesës ose pengesës së tij, këto obligime i kryen zëvendëskryetari i ZNKB-së.

(2) ZNKB punon me kuorum nga së paku pesë anëtarë.

(3) Kryetari i ZNKB-së për punën e ZNKB-së rregullisht e njofton ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(4) Kryetari dhe anëtarët e ZNKB-së kanë të drejtë të kompensimit mujor në lartësi prej një rrogë mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas të dhënave të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, kompensim i cili paguhet nga buxheti i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(5) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës siguron ueb faqe të ZNKB-së dhe azhurnimin e të njëjtës, si dhe kapacitete administrative, kushte teknike, hapësinore dhe të tjera të domosdoshme për punën e ZNKB-së.

(6) ZNKB-së në ueb faqen e vet e informon publikun për aktivitetet e veta në zbatimin e kompetencave, për zhvillimin e tregut brodbend në shtet në raport me tregun brodbend në Bashkimin Evropian, në pajtim me DESI, për zbatimin e dokumenteve dhe planeve strategjike të miratuara për zhvillimin e brodbendit në shtet, përmbushjen e trageteve nacionale brodband të përcaktuara në të njëjtat etj.

(7) ZNKB-së për punën e vet miraton Rregullore.“.

Neni 5

Titulli në nenin 75-a dhe neni 75-a ndryshohen si vijojnë:

"Neni 75-a

### **“Çmime për roaming ndërkombëtar dhe kryerje të thirrjeve ndërkombëtare**

(1) Agjencia ka të drejtë që operatorëve që posedojnë rrjete publike mobile të komunikimit dhe sigurojnë shërbime mobile publike të komunikimit t'ju përcaktojë çmime maksimale të shërbimeve që i ofrojnë në roaming shfrytëzuesve nga vendet me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje, memorandum, kontratë ose protokoll për zvogëlimin e çmimeve të shërbimeve të roamingut në rrjetet mobile publike të komunikimeve, në baza reciproke, të cilat nuk mund të jenë më të larta se çmimet e shërbimeve të njëjta që vlejné ndërmjet vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

(2) Çmimet maksimale të shërbimeve nga paragrafi (1) të këtij neni Agjencia do t'i përcaktojë me vendim, të miratuar në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

(3) Operatorëve të cilët sigurojnë shërbime publike elektronike të komunikimit Agjencia ka të drejtë t'u përcaktojë çmime maksimale të shërbimeve të shitjes me shumicë për kryerjen e thirrjeve ndërkombëtare nga vendet me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje, memorandum, kontratë ose protokoll për të njëjtën, në baza reciproke.

(4) Në rastin kur operatori siguron shërbime roaming me çmime të barabarta me çmimet e shërbimeve të shitjes me pakicë vendase dhe e njëjta do të kontribuojë në joshpagueshmërinë dhe paqëndrueshmërinë ekonomike nga sigurimi i shërbimeve roaming të operatorit, me pëlqimin paraprak të Agjencisë, operatori mund t' rrisë çmimet e shërbimeve roaming të shitjes me pakicë.

(5) Kur operatori siguron shërbime roaming me çmime të barabarta me çmimet e shërbimeve të shitjes me pakicë vendase, i njëjti mund të zbatojë politika për përdorim të drejtë të shërbimeve roaming me çfarë do të parandalojnë abuzimin e të njëjtave dhe i njëjti është i detyruar politikën e përdorimit të drejtë ta publikojë dhe miratojë në mënyrë transparente.

(6) Mënyrën e vlerësimit të joshpagueshmërinë dhe paqëndrueshmërisë ekonomike në punën e operatorit nga sigurimi i shërbimeve roaming nga paragrafi (4) i këtij neni, mënyrën e parashtrimit të kërkesës për rritjen e çmimeve të shërbimeve roaming të shitjes me pakicë, si dhe politikat për përdorimin e drejtë nga paragrafi (5) i këtij neni, Agjencia do t'i përcaktojë me akt nënligjor.“.

#### Neni 6

(1) Shumën e mjeteve për vitin 2019, të përcaktuara me nenin 3 të këtij ligji, Agjencia do ta llogaritë në bazë të të ardhurave të realizuara nga operatorët përfundimisht deri më 30 qershor 2019 dhe është e obliguar atë shumë t'ia paguajë Agjencisë Operative Teknike më së voni në afat prej 8 (tetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

(2) Shumat tjera të kompensimeve të përcaktuara në nenin 3 të këtij Ligji, që kanë të bëjnë me vitin 2019, Agjencia është e obliguar t'ia paguajë Agjencisë Operative Teknike më së voni në afat prej 8 (tetë) ditësh pas skadimit të secilit tremujor veçmas, përfundimisht me dhjetorin 2019.

#### Neni 7

(1) Konkursi publik për zgjedhje të ekspertëve të pavarur, anëtarë të ZNKB-së, në pajtim me kushtet e këtij ligji, do të shpallet më së voni në afat prej 8 (tetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

(2) Aktvendimin për formimin e ZNKB-së do ta miratojë ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës më së voni në afat prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 8

Neni 5 i këtij ligji do të fillojë të zbatohet nga 1 korriku 2021.

#### Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.